



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0045236/25 të datës 31.07.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Riza Konushevci, nga fshati Llugë, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore si dhe kushteve të vështira të banimit i jepet ndihmë financiare në shumë 4,000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Riza Konushevc (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/04-0046995/25
Podujevë, datë, 06.08.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0045463/25 të datës 01.08.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Flamur Zeneli, nga Podujeva për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Flamur Zeneli (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/04-0046993/25
Podujevë, datë, 06.08.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 13400€, ndihmë për gjashtëdhjetetë (63) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin korrik 2025, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0047972/25
Podujevë, datë 08.08.2025



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, të datës 26.09.2024, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027, në implementim të projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0030745/25 të datës 04.06.2025 në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0036153/25 të datës 27.06.2025 për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 73,022.00€, nga e cila 51,115.40€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, si dhe 21,906.60€ apo 30% e vlerës së participimit nga ana e fermerëve përfitues në projektin e komunës "Furnizim me mekanizëm bujqësor", përkatësisht për 68 fermer përfitues, dhe atë për;

- Motokultivatorë me frezë 75 cm.....25 fermer përfitues
- Shpërndarëse plehu 300 – 350 l me kardon.....20 fermer përfitues
- Makinë mjelëse për dy lopë.....23 fermer përfitues

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Furnizim me mekanizëm bujqësor".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor", sipas neni 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/04-0049557/25
Podujevë, datë, 13.08.2025





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat” me Marrëveshjen Kornizë të Kredisë ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit në mes MMPHI dhe Komunës së Podujevës për Projektin e “Banimit Social Adekuat”, duke marrë parasysh nevojën për organizim, implementimin dhe menaxhim të efektshëm të Projektit përmes nën-projekteve për Banimin Social Adekuat në territorin e Komunës së Podujevës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Njësitit të Implementimit të Projektit në kuadër të Projektit të Banim Social Adekuat

Neni 1

Themelimi dhe operimi i Njësitit të Implementimit të Projektit

1. Në kuadër të Komunës së Podujevës, themelohet Njësi për Implementimin e Projektit (në tekstin e mëtejme NjIP) për Banimin Social Adekuat.
 - 1.1 NjIP, do të funksionojë si organ kryesor i Implementimit të Projektit përmes nën-projekteve të Banimit Social Adekuat në kuadër të Komunës dhe si ndihmës i organit kompetent komunal për menaxhimin e kontratave dhe Projektit të Banimit Social Adekuat përmes nën-projekteve.
 - 1.2 Stafi i NjIP-së, emërohet nga Kryetari i Komunës, nga stafi i brendshëm i administratës Komunale të Drejtorive përkatëse ose në mungesë të stafit të brendshëm angazhohen anëtarë / profesionistë të kontraktuar (OE), me kohëzgjatje gjerë në përfundim të Projektit të Banimit Social Adekuat përmes nën-projekteve.
 - 1.3 Niveli i angazhimit të stafit të NjIP-së determinohet në koordinim me Kryetarin e Komunës, udhëheqësit e Drejtorive përkatëse të Komunës dhe kërkesave specifike të Projektit të Banimit Social Adekuat.
 - 1.4 Të gjitha kostot e punëve shtesë ose pagave të stafit të emëruar / angazhuar, si dhe kostot e operimit të NjIP-së mbulohen nga buxheti komunal, përfshirë akomodimin e stafit të NjIP-së në ambientet e Komunës për koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë relevante komunale.
 - 1.5 Për kërkesat specifike të implementimit të Projektit të Banimit Social Adekuat përmes nën-projekteve, NjIP do të operojë edhe në bazë të udhëzimeve dhe kërkesave të parapara në Manualin e Operimit (MO) si pjesë e Manualit të Implementimit të Projektit (MIP).

Neni 2

Përbërja

1. NjIP, përbëhet nga pesë (5) anëtarë, me njërin nga anëtarët si udhëheqës, të emëruar nga drejtoritë reprezentative komunale (Urbanizëm, Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi, Buxhet/Financa, Prokurim, Gjeodezi/Kadastër), si staf i punësuar në Drejtoritë Komunale, ose në rast mungese me profesionistë të kontraktuar nga jashtë (OE).
 - 1.1. **Veton Aliu**, *Udhëheqës i NjIP, Inxhinier në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit*
 - 1.2. **Arbresha Bashota**, *anëtare, zyrtare për shërbime sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*
 - 1.3. **Florie Humolli**, *anëtare, zyrtare ligjore në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë*
 - 1.4. **Alban Shabani**, *anëtar, zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave*
 - 1.5. **Driton Kiçmari**, *anëtar, zyrtar i prokurimit në Zyrën e Prokurimit*

Neni 3

Detyrat dhe Përgjegjësitë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e NjIP-së janë:
 - 1.1 **Planifikimi dhe përgatitja e nën-projekteve:** NjIP-ja është përgjegjëse për identifikimin e nevojave lokale dhe zhvillimin e nën-projekteve që adresojnë këto nevoja, duke siguruar përputhshmërinë me objektivat e projektit të Banimit Social Adekuat.
 - 1.2 **Monitorimi i procedurave të tenderimit dhe kontraktimit:** NjIP-ja organizon dhe mbikëqyr proceset e tenderimit për punët ndërtimore dhe shërbimet e nevojshme, duke siguruar transparencë dhe konkurrencë të ndershme, si dhe monitoron zbatimin e kontratave, për të siguruar përputhshmëri me kushtet teknike, afatet dhe kërkesat e cilësisë.
 - 1.3 **Mbikëqyrja e zbatimit të nën-projekteve:** NjIP-ja monitoron progresin e punimeve dhe aktivitetet e tjera të nën-projekteve, duke siguruar që ato të realizohen sipas standardeve të përcaktuara dhe brenda afateve kohore.
 - 1.4 **Menaxhimi i financave dhe raportimi:** NjIP-ja menaxhon buxhetin e nën-projekteve, siguron përdorimin e duhur të fondeve dhe përgatit raporte të rregullta për autoritetet përkatëse (Njësitin e Menaxhimit të Projektit/Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).
 - 1.5 **Sigurimi i cilësisë dhe kontrolli i punimeve:** NjIP-ja implementon mekanizma për kontrollin e cilësisë gjatë gjithë ciklit të zbatimit të nën-projekteve, duke përfshirë inspektime të rregullta dhe verifikime të materialeve dhe punimeve, si dhe monitorim të zbatimit të standardeve mjedisore që synojnë parandalimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e ndikimeve negative mjedisore të përcaktuara në Kornizën për Menaxhimin Mjedisor dhe Social si pjesë e Manualit të Implementimit të Projektit.
 - 1.6 **Angazhimi me komunitetin dhe përfituesit:** NjIP-ja siguron përfshirjen e komunitetit dhe përfituesve në proceset e vendimarrjes dhe zbatimit, duke organizuar takime informuese dhe konsultime për të adresuar nevojat dhe shqetësimet e tyre.

- 1.7 **Raportimi dhe komunikimi i rregullt me autoritetet qendrore:** NjIP-ja mban komunikim të rregullt me Njësine e Menaxhimit të Projektit (NjMP)/Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) si dhe raporton rregullisht me kërkesë të NjMP / MMPHI, për të siguruar përputhshmërinë me politikat dhe procedurat qendrore.
- 1.8 **Pjesëmarrja aktive në komisione verifikuese/vlerësuese:** NjIP merr pjesë aktive në verifikim dhe vlerësim të përfituesve, përfshirë edhe vizita në terren (inxhinieri/arkitekti i NjIP).

Neni 4

Hyrja në fuqi dhe zbatimi i vendimit

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatimi i tij është i obligueshëm për të gjithë anëtarët e Njësitit të Implementimit të Projektit (NjIP).

*Vendimi i dërgohet:
Anëtarëve të NjIP-së
QSHQ / Arkivit.*

*Nr. Prot. 02-020/04-0050442/25
Podujevë, datë; 15.08.2025*

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0048553/25 të datës 11.08.2025, merr:

V E N D I M **PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

Neni 1

znj.Bahrije Jahja, nga fshati Dumnicë e Poshtme, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore si dhe kushteve të vështira ekonomike i jepet ndihmë financiare në shumë 400.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

Znj.Bahrije Jahja (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot. 02-400/01-0052189/25
Podujevë, datë, 19.08.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 3 paragrafi 3, dhe nenin 27 të Rregullores (Komunale) për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 datë 29.04.2022, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-401/01-0065086/24 datë 26.09.2024 për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027, sipas Thirrjes publike nr.prot.09-615/03-0036275/25 datë 27.06.2025 për financimin e projekt propozimeve individuale për organizmin e aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës, në Rekomandim të Komisionit ad-hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, i ngritur nga Kryetari i Komunës me Vendimin nr.02-020/04-0040765/25 datë 15.07.2025, merr,

V E N D I M

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE INDIVIDUALE PËR ORGANIZMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE, KULTURORE DHE ARTISTIKE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financimin e projekt propozimeve individuale për organizmin e aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike nr.prot.09-615/03-0036275/25 datë 27.06.2025, lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme 17,600.00€.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për kushtet dhe mënyrën e realizmit të aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidh kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren (Komunale) për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 datë 29.04.2022.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas Listës përfundimtare të përfituesve pjesë përbërëse e këtij Vendimi, nuk e tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores (Komunale) për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 4

Zbatimin e këtij Vendimi e bëjnë Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


*U dërgohet;
DKRS dhe DBF
QSHQ/Arkivës*

Nr. prot. 02-400/04-0053322/25
Podujevë, datë: 22.08.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat” me Marrëveshjen Kornizë të Kredisë ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit në mes MMPHI dhe Komunës së Podujevës për Projektin e “Banimit Social Adekuat”, duke marrë parasysh nevojën për organizim, implementimin dhe menaxhim të efektshëm të Projektit përmes nën-projekteve për Banimin Social Adekuat në territorin e Komunës së Podujevës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komisionit Vlerësues për Shprehjen e Interesit - Aplikacionet për nën-projektin ‘Renovimi / Rindërtimi i Shtëpive Private për Familjet apo Individët e Cenueshëm’, në kuadër të Projektit të “Banimit Social Adekuat”

Neni 1

Themelimi i Komisionit

1. Në kuadër të Komunës së Podujevës, themelohet Komisioni Vlerësues për verifikim dhe vlerësim të Shprehjes së Interesit – Aplikacioneve – për nën-projektin ‘Renovimi/Rindërtimi i Shtëpive Private për Familjet apo Individët e Cenueshëm’, në kuadër të obligimeve të Komunës për përzgjedhjen pa diskriminim të Përfutuesve Përfundimtar si një parim themelor i implementimit të Projektit të Banimit Social Adekuat përmes nën-projekteve.
2. Komisioni Vlerësues për verifikim dhe vlerësim të Shprehjes së Interesit – Aplikacioneve - do të funksionojë si organ kompetent komunal për pranimin, shqyrtimin, vlerësimin dhe verifikimin në terren të shprehjes së interesit për Renovim/Rindërtim të Shtëpive Private për Familjet apo Individët e Cenueshëm, duke bërë verifikimin e gjendjes ekonomike të familjeve/individëve dhe gjendjes aktuale-fizike të shtëpive për renovim/rindërtim, si nën-projekt në kuadër të Projektit të Banimit Social Adekuat.

Neni 2

Përbërja

1. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë të emëruar nga drejtoritë reprezentative të administratës komunale (Urbanizëm, Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi, Buxhet/Financa, Gjeodezi/Kadastër) dhe anëtar të Njësitit të Implementimit të Projektit:
 - 1.1. **Veton Aliu**, kryesues i komisionit, Inxhinier në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
 - 1.2. **Arbresha Bashota**, anëtare, zyrtare për shërbime sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
 - 1.3. **Florie Humolli**, anëtare, zyrtare ligjore në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë
 - 1.4. **Alban Shabani**, anëtar, zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave
 - 1.5. **Driton Këçmari**, anëtar, zyrtar i prokurimit në Zyrën e Prokurimit

Neni 3

Detyrat dhe Përgjegjësitë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioni Vlerësues për verifikim dhe vlerësim të Shprehjes së Interesit – Aplikacioneve – për nën-projektin 'Renovimi/Rindërtimi i Shtëpive Private për Familjet apo Individët e Cenueshëm', janë:
 - 1.1. Krijimi i bazës së të dhënave nga aplikacionet e pranuar, ku përfshihen numri i kërkesave për renovim dhe rindërtim të shtëpive private, numri i familjeve, individëve, struktura gjinore, gjendja e shtëpive, infrastrukturës dhe të dhënat tjera relevante të kërkuara për t'u bartur në Formularin e Aplikimit për nën-projektin "renovimi i shtëpive private për familje apo individët e cenueshëm", në kuadër të Projektit "Banimi Social Adekuat" në Kosovë.
 - 1.2. Verifikimi i gjendjes ekonomike për familjet/individët që kanë shprehur interesin për renovim / rindërtim të shtëpive private, duke përfshirë shqyrtimin e Formës së kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm (shtojca 1 dhe shtojca 2), si dhe verifikimin dhe vlerësimin në terren të familjes dhe gjendjes aktuale-fizike të shtëpisë për renovim / rindërtim.
 - 1.3. Komisioni Vlerësues është i detyruar të zbatojë kriteret e përcaktuara të poentimit dhe radhës së përparësisë të bashkëngjitura si shtojcë në këtë vendim (shtojca 4).
 - 1.4. Mosdiskriminimi gjatë përzgjedhjes së Përfituesve Përfundimtarë duhet të jetë një parim themelor në fillimin dhe implementimin e Projektit përmes nën-projektit për Renovim/Rindërtim të Shtëpive Private, me prioritizim të familjeve më të cenueshme si kategori të varfra apo ekstrem të varfra, me marrjen e masave specifike për të siguruar respektimin e këtij parimi.
 - 1.5. Konsideratat gjinore duhet të përfshihen nga fillimi, hartimin dhe zbatimi i projektit, me konsideratë të veçantë në: dhënien përparësi ekonomive familjare të udhëhequra nga gratë dhe grave beqare, dhe veçanërisht grave viktimat të dhunës seksuale ose në familje, në përzgjedhjen e Përfituesve Përfundimtarë në Komunë, si dhe kërkesa që dokumentet e qëndrimit (vërtetimi i pronësisë) të jenë (vetëm ose gjithashtu) në emër të grave.

1.6. Pas përfundimit të verifikimit dhe vlerësimit, Komisioni Vlerësues përgatitë raportin përfundimtarë dhe dorëzon Formularin e Aplikimit me dokumentacionin përcjellës pranë Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP) të Banimit Social Adekuat në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe vetëm pas miratimit të kërkesave dhe buxhetit nga NjMP/MMPHI, Komisioni Vlerësues është i obliguar të njoftojë familjen/individin për rezultatet.

Neni 4 **Zbatimi i Vendimit**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatimi i tij është i obligueshëm për të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues.

Vendimi i dërgohet:
Anëtarëve të NjIP-së
QSHQ / Arkivit.

Nr. Prot. 02-02064-005574/25
Podujevë, datë: 27.06.2025

Kryetari i Komunes
Shpejtim Balliqi



Këtij vendimi i bashkëngjiten:

1. Shtojca Nr.1: Forma e Kërkesës - Formulari i Shprehjes së Interesit për Përfituesit për Rinovim/Rindërtim të Shtëpive Private;
2. Shtojca Nr.2: Lista Kontrolluese mbi kushtet e banimit në shtëpitë private, bazuar në inspektimin vizual nga Komuna;
3. Shtojca Nr.3: Dokumentet që duhet të dorëzohen nga Aplikuesi;
4. Shtojca Nr.4: Tabela e Vlerësimit sipas Kritereve të Përparësisë.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0055592/25 të datës 28.08.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Hava Bulliqi, nga fshati Llugë, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore si dhe kushteve të vështira ekonomike i jepet ndihmë financiare në shumë 1000€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtoria përkatëse.
QSHQ/Arkivit.
Znj.Hava Bulliqi (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/03-0055917/25
Podujevë, datë, 29.08.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, të datës 26.09.2024, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027, në implementim të projektit "Përkrahje me Mekanizëm për Blegtori – Lot II", sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0035748/25 të datës 25.06.2025 në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0041252/25 të datës 16.07.2025 për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 41,990.00€, nga e cila 29,393.00€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, si dhe 12,597.00€ apo 30% e vlerës së participimit nga ana e fermerëve përfitues në projektin e komunës "Përkrahje me Mekanizëm për Blegtori – Lot II", përkatësisht me;

- Laktofriz 300 L.....10 fermer përfitues
- Mikser për ushqim voluminoz 2m³.....5 fermer përfitues

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Përkrahje me Mekanizëm për Blegtori – Lot II".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e "Përkrahje me Mekanizëm për Blegtori – Lot II", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/03-0056052/25
Podujevë, datë, 29.08.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

